

VENDIM
Nr. 983, datë 9.12.2015

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS POPULLORE TË
KINËS, PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIKO-TEKNIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Popullore të Kinës, për bashkë-punimin ekonomik-teknik, sipas tekstit bashkë-lidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE
PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIKO-TEKNIK NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS POPULLORE TË
KINËS

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës Popullore të Kinës, për të zhvilluar më tej marrëdhëniet e bashkëpunimit miqësor dhe të bashkëpunimit ekonomik-teknik midis dy vendeve, bien dakord sa më poshtë vijon:

Neni 1

Sipas nevojave të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeveria e Republikës Popullore të Kinës i jep një ndihmë falas Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, me vlerë prej 10 (dhjetë) milionë shyuam RMB.

Neni 2

Ndihma e sipërpërmendur do të përdoret për objekte që do të përcaktohen bashkërisht nga qeveritë e të dyja vendeve. Çështjet konkrete do të caktohen në marrëveshje të tjera që do të lidhen mes palëve.

Neni 3

Modalitetet teknike financiare që kanë lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të përcaktohen nga Banka e Zhvillimit të Kinës dhe nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën kur palët njoftojnë njëra-tjetrën mbi përfundimin e procedurave të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të marrëveshjeve dhe do të jetë e vlefshme derisa të dyja qeveritë të përmbushin të gjitha detyrimet e përcaktuara në këtë marrëveshje.

Neni 5

Kjo marrëveshje nënshkruhet në Tiranë, në datën 23.1.2014, në dy kopje origjinale, ku secila palë mban nga një kopje. Çdo kopje nënshkruhet në gjuhën shqipe, në gjuhën kineze dhe angleze dhe secili

version me përmbajtje të njëjtë.